

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta Ndërkombëtare Ekonomike
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	E obligueshme
Viti i studimeve:	
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Qerim Qerimi
Detajet kontaktuese:	gerim.qerimi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	<p>E Drejta Ndërkombëtare Ekonomike përcakton rregullat që aplikohen në çështje të natyrës ekonomike e komerciale, me theks të veçantë në kontestet ekonomike apo biznese të cilat zgjidhen nga gjykatat apo mjetet alternative të zgjidhjes së kontesteve siç janë arbitrazhi, ndërmjetësimi dhe negociatat. Lënda po ashtu do të përfshijë rregullativën ligjore të aplikueshme për tregti ndërkombëtare si dhe çështje që kanë të bëjnë me traktatet bilaterale të investimeve (anglisht <i>BIT</i>) dhe kontestet që dalin nga këto traktate e që zgjidhen nëpërmjet <i>ICSID</i> (Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve).</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Kjo lëndë ka për qëllim studimin e rregullave ligjore që përcaktojnë marrëdhëniet ekonomike në mes të shteteve, duke u përqëndruar, ndër të tjera, në marrëdhëniet tregtare si dhe çështje të investimeve. Kjo do të përfshijë në mënyrë të veçantë studimin e organizatave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare dhe rajonale të tregtisë, siç janë WTO (Organizata Botërore e Tregtisë), CEFTA (Central European Free Trade Agreement) dhe NAFTA (North American Free Trade Agreement). Çështjet që dalin nga zbatimi i këtyre marrëveshjeve po ashtu do të studiohen, me theks në zgjidhjen e kontesteve tregtare që lidhen me moszbatimin e pjesëve të caktuara të këtyre marrëveshjeve.</p>

Zgjidhja e kontesteve mes palëve (që kanë karakter ekonomik) do të përbëjë pjesë kyçe të ligjëratave dhe ushtrimeve. Për këtë qëllim, studentët do të analizojnë dhe prezentojnë role të palëve në raste konkrete të zgjidhura nga panele apo gjykata ndërkombëtare. Ata, po ashtu, do të prezentojnë edhe zgjidhje konkrete për këto konteste, nëpërmjet metodave të ndryshme të zgjidhjes alternative të kontesteve (ADR) siç janë: arbitrazhi, negociatat dhe ndërmjetësimi. Zgjidhja e kontesteve do të përqendrohet në tri segmente kryesore: 1. Zgjidhja e kontesteve në OBT; 2. Zgjidhja e kontesteve në sistemin evropian, dhe 3. Zgjidhja e kontesteve nga kontratat ndërkombëtare të shitjes së mallrave.

Një pjesë e rëndësishme e ligjëratave dhe ushtrimeve do t'i dedikohet studimit të transaksioneve ndërkombëtare (kontratat e eksportit dhe importit) dhe rregullave ligjore që kanë të bëjnë me këto transaksione. Për më tepër, çështje që kanë të bëjnë me letrat me vlerë (LoC) dhe dokumentet e tjera të transaksionit do të studiohen nga aspekti ligjor edhe nëpërmjet rasteve konkrete të vendosura nga gjykata e tribunale arbitrazhi të ndryshme.

Po ashtu, do të studiohen edhe shembuj të traktateve bilaterale të investimeve (BIT) dhe kontestet e ndryshme që përfshijnë shtete sovraane në ICSID.

Në këtë lëndë, do të analizohet në veçanti edhe Konventa Ndërkombëtare për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave (CISG), e cila është e aplikueshme edhe në Kosovë. Tregtia ndërkombëtare me mallra përbën pjesë të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare ekonomike, dhe kjo konventë është dokumenti kryesor ligjor që në mënyrë uniforme ka përcaktuar rregullat që duhet të aplikohen nga gjykatat apo forumet e tjera për të zgjidhur kontestet që dalin nga kontratat me karakter ndërkombëtar. Prandaj, gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, studentet do të analizojnë rregullat në këtë Konventë që kanë të bëjnë me formimin e kontratave, të drejtat dhe detyrimet e palëve, kompensimin e dëmit si dhe aplikueshmërinë e kësaj konvente në shtete të

	ndryshme, duke pasur po ashtu parasysh çështje që kanë të bëjnë me suksedimin e traktateve si dhe rezervimet e deklarimet e shteteve me rastin e ratifikimit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët janë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kuptojnë dhe shpjegojnë rregullat kryesore të aplikueshme në të drejtën ndërkombëtare ekonomike, me theks në rregullat e tregtisë ndërkombëtare si dhe ato që aplikohen në traktate bilaterale të investimeve; 2. Njohin dhe përdorin procedurat e përdorura nga gjykatat apo arbitrazhet në zgjidhjen e kontesteve të natyrës ekonomike ndërkombëtare; 3. Analizojnë dhe diskutojnë rastet e vendosura nga ICSID që kanë të bëjnë me investime si dhe rastet e vendosura nga gjykata e forume të tjera ndërkombëtare (siç është arbitrazhi) që ndërlidhen me kontrata të tregtisë ndërkombëtare; 4. Përdorin dhe analizojnë raste dhe dokumente ligjore në kontekst të problemeve konkrete në botën reale.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15/javë	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15/javë	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15/javë	30
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare,pune grupore	3	3	9
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit	2	15	30

(në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	2	2	4
Totali	21		172

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Kjo lëndë ligjërohet duke u bazuar në raste konkrete. Prandaj, të gjitha konceptet do të diskutohen në kontekst të rasteve të vërteta (të vendosura nga gjykata e arbitrazhe) ose hipotetike (të hartuara nga profesori i lëndës).</p> <p>Pra, nuk do të prezantohen vetëm rregullat themelore në burimet e përshkruara, por problemet më të shpeshta që shfaqen gjatë aplikimit të tyre, për të ndriçuar strukturën e tyre dhe problemet interpretuese që lidhen me to.</p> <p>Profesori do të përdorë metodën sokratike gjatë ligjëratave, në mënyrë që të ketë angazhim sa më ndërveprues në klasë.</p>
-------------------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	<p><i>10% - Pjesëmarrja dhe aktiviteti në ligjëratat</i> <i>20% - prezantimet e rasteve</i> <i>20% - test mes-semestral</i> <i>50% - provimi përfundimtar</i></p> <p>Do të ketë një politikë rigoroze në përcaktimin e vijueshmërisë së lëndës. Pjesëmarrja aktive, përmbajtjesore dhe e rregullt në ligjëratat vlerësohet me 10 për qind (%). Nëse pjesëmarrja, në <u>cilësi</u> dhe <u>vijueshmëri</u>, është e mjaftueshme për të marrë këtë përqindje, vendimi përfundimtar për të përcaktuar këtë i takon profesorit të lëndës.</p>
------------------------------	---

Literatura	
Literatura bazë:	<p>1. Andreas F. Lowenfeld International Economic Law Oxford University Press, 2008</p>

	<p align="center">2. Mehdi Hetemi</p> <p>E drejta ndërkombëtare tregtare –afariste Prishtinë, 2007</p>
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Konventa e Kombeve të Bashkuara për Shitjet Ndërkombëtare të Mallrave</i> • <i>Konventa e Kombeve të Bashkuara për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit</i> • <i>Materiale shtesë nga OBT (WTO)</i> • <i>Materiale shtesë nga CEFTA</i> • <i>Materiale shtesë nga ICSID (Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve)</i> • <i>Ligjet e Kosovës në fushën e investimeve, detyrimeve, tregtisë, etj.</i>
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	<p align="center">Hyrje në të drejtën ndërkombëtare ekonomike</p> <p align="center">(Përmbajtja e lëndës, metoda, organizimi, kërkesat dhe vlerësimi)</p> <p align="center"><i>Lowenfeld, 1-21</i></p> <p align="center"><i>Shembuj të ligjeve të Kosovës që mbulojnë sferën ekonomike (të dërguara nga Profesori i lëndës)</i></p>
<i>Java e dytë:</i>	<p align="center">Sistemi i OBT-së (WTO)</p> <p align="center"><i>Lowenfeld, 21-71</i></p> <p align="center"><i>WTO's website – KLIKO ne: "What is the WTO"</i></p> <p align="center">http://www.wto.org/english/thewto_e/whatis_e/whatis_e.htm</p>
<i>Java e tretë:</i>	<p align="center">Procesi i Anëtarësimit në OBT</p> <p align="center">Sfidat e anëtarësimit të Kosovës në OBT</p> <p align="center"><i>Shih kriteret dhe rregullat për anëtarësim në www.wto.org</i></p>

<p>Java e katërt:</p>	<p align="center">Marrëveshjet Rajonale për Tregti të Lirë CEFTA dhe NAFTA</p> <p align="center"><i>Materialet rreth CEFTA: http://ceftatradeportal.com Teksti i marrëveshjes në shqip: http://mti-ks.org/repository/docs/20070123165311_cefta.pdf Materialet rreth NAFTA: https://www.nafta-sec-alena.org/Home/Welcome</i></p>
<p>Java e pestë:</p>	<p align="center">Rregullat Ligjore që kanë të bëjnë me Investimet Ndërkombëtare Traktatet Bilaterale të Investimeve</p> <p align="center"><i>Lowenfeld, 465-500 WWW.ICSID.COM</i></p> <p align="center">&</p> <p align="center">Zgjidhja e kontesteve në ICSID (Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve) <i>Rasti AXOS kundër Republikës së Kosovës: http://icsidfiles.worldbank.org/icsid/ICSIDBLOBS/OnlineAwards/C4526/DS11107_En.pdf</i></p>
<p>Java e gjashtë:</p>	<p align="center">Zgjidhja e Kontesteve Ekonomike Ndërkombëtare</p> <p align="center"><i>Lowenfeld, 143-213</i></p> <p align="center">Zgjidhja e Kontesteve në OBT: https://www.wto.org/english/tratop_e/dispu_e/dispu_e.htm</p>
<p>Java e shtatë:</p>	<p align="center">Testi mes-semestral</p>
<p>Java e tetë:</p>	<p align="center">Zgjedhja e Ligjit të Aplikueshëm dhe Zgjedhja e Forumit në kontratat ndërkombëtare</p> <p><u>Docs: U.N. Convention on Recognition and Enforcement of Foreign Arbitral Awards; 2005 Hague Convention on Choice of Court Agreements,</u></p>

	<p>SHIH: http://www.hcch.net/index_en.php?act=conventions.text&cid=98</p>
<i>Java e nëntë:</i>	<p>Zgjidhja e Kontesteve Tregtare në Sistemin Evropian</p> <p><i>European Council Regulation (EC) No 44/2001 of 22 December 2000 on jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in civil and commercial matters (Brussels Regulation)</i></p> <p>KLIKO NE : http://europa.eu.int/eur-lex/pri/en/oj/dat/2001/l_012/l_01220010116en00010023.pdf</p>
<i>Java e dhjetë:</i>	<p>Konventa Ndërkombëtare për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave (CISG)</p> <p>Teksti i Konventës: http://www.cisg.law.pace.edu/cisg/text/treaty.html</p>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<p>Aplikimi i CISG në Kosovë</p> <p><i>Rregullorja e UNMIK-ut 2000/68</i> <i>Ligji i Detyrimeve 2012</i> <i>Teksti i Konventës CISG</i></p>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<p>Rregullat e aplikimit të CISG si dhe rregullat e formimit të kontratave ndërkombëtare për shitjen e mallrave</p> <p><i>Pjesa I dhe II e CISG</i> <i>Raste hipotetike dhe vendime të gjykatave e arbitrazheve</i> & Të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontratat ndërkombëtare për shitjen e mallrave</p> <p><i>Pjesa III e CISG</i> <i>Raste hipotetike dhe vendime të gjykatave e arbitrazheve</i></p>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<p>Kompensimi i dëmit dhe <i>restitutio</i> në kontratat ndërkombëtare</p> <p><i>Kapitulli V në Pjesën III të CISG</i> <i>Raste hipotetike dhe vendime të gjykatave e arbitrazheve</i></p> <p>&</p>

	<p style="text-align: center;">Dispozitat përfundimtare në CISG: Ratifikimi, Suksedimi, Deklaratat dhe Rezervimet</p> <p style="text-align: center;"><i>Pjesa IV e CISG</i> <i>Raste hipotetike dhe vendime të gjykatave e arbitrazheve</i></p>
<p><i>Java e katërbëdhjetë:</i></p>	<p style="text-align: center;">Provimi përfundimtar</p>